



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.07.2023)

Pika 41 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 13, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:27 dhe mbaroi në orën 12:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej si pike e 43 sipas rendit të ditës.

9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
7. *Edmond Hoxhaj (BIRN).*

RENDI I DITËS:

41. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 13, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Atëherë, pasi përfunduar çështjet me dyer të mbyllura, kalojmë sipas rendit të ditës. Por përpara se të kalojmë në rendin e ditës, kam një propozim nga kryetari i KZHK-së, që të përfshihet sot në rendin e ditës çështja që për efekt të përditësimit të informacionit u hoq nga dita e djeshme, që bëhet fjalë për shqyrtimin e projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionet e lira me nr. 12 dhe nr. 13”. Jemi dakord që të shtohet në fund të rendit kjo?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Naureda Llagami: Fillojmë fillimisht me përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 13, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}. Fjalën ia jap zotit Kurushi.

Merr fjalën zoti Kurushi për të relatuar relacionin përshkrues të projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 13, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}”.

Ndër të tjera lexohen pjesë nga relacioni:

Me vendimet nr.11- nr.24, datë 18.01.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur hapjen e katërmbëdhjetë procedurave të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 13, datë 18.01.2023 për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, ku brenda afatit të kandidimit për këtë pozicion kandidoi edhe z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë (aktualisht gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë).

Me vendim nr. 294, datë 30.05.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 136, në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjat “c” dhe “ë”, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 7, 8 dhe 9 të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”, i ndryshuar, si dhe në pikën 75, Kreu VI, të Vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”

vendosi fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës për pozicionet e shpallura të lira me vendimet nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21 dhe 24, datë 18.01.2023.

Më datë 31.05.2023, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 75, Kreu VI, të Vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, kandidati u njoftua për vendimin nr. 294, datë 30.05.2023. Kandidati nuk paraqiti kundërshtime ose kërkesa për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

Më datë 17.07.2023, kandidati z. {...}, ka paraqitur kërkesën për tërheqjen nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë nr. 13 datë 18.01.2023, në fushën e të drejtës civile, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, protokolluar në Këshill me aktin nr. {...} prot., datë 17.07.2023, duke parashtruar se: “Me vullnetin tim të lirë dhe të plotë deklaroj se tërhiqem nga kandidimi im në procedurën e lëvizjes paralele në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 13, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Në rrethanat sa sipër, përgatitet ky relacion bazuar në pikën 107, Seksioni “D”, Kreun VI të Vendimit të Këshillit nr. 320, datë 17.09.202.

Në përfundim, Komisioni i propozon Këshillit:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.13, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

* * *

(Pika 41 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.07.2023)

Pika 42 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2022”, relatore znj. Brikena Ukperaj.²

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:27 dhe mbaroi në orën 12:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
11. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej si pike e 41 sipas rendit të ditës.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

7. Edmond Hoxhaj (BIRN).

RENDI I DITËS:

42. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2022”, relatore znj. Brikena Ukperaj.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e radhës e rendit të ditës që ka të bëjë me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për vitin 2022.

Zoti {...} nuk është prezent. Ka marrë dijeni për projekt-raportin dhe për seancën e shqyrtimit të tij, kështu që pa humbur kohë ia japim fjalën zonjës Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Gjyqtari {...} është një nga kandidatët që ka aplikuar në procedurat e lëvizjes paralele dhe është kualifikuar si i tillë. Për këtë arsye, përveç vlerësimit trevjeçar 2017-2019, nga ana e Këshillit ka filluar edhe vlerësimi i përshpejtuar për vitin kalendarik 2022.

Procedura e vlerësimit të përshpejtuar i detyruar për gjyqtarin ka filluar me vendimin nr.144, datë 28.03.2023 dhe ka përfunduar nga ana e Komisionit me vendimin e datës 06.06.2023, pasi është konstatuar vlerësimi i plotësisë së dokumentacionit dhe procedurave të ndjekura në krijimin e dosjes së vlerësimit të gjyqtarit.

Gjyqtari është njoftuar për raportin e vlerësimit. Është njoftuar për raportin analitik të përgatitur nga NPV me evidentimin e të gjitha të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit. Ka paraqitur brenda afatit 7-ditor kundërshtimet e tij lidhur me projektraportin dhe njëkohësisht edhe disa prova të reja të cilat unë do t'i relatoj në treguesin përkatës për të cilin gjyqtari ka paraqitur kundërshtime, bashkë me qëndrimin tim si relatorë, ndërkohë që gjyqtari është njoftuar edhe për seancë dëgjimore dhe nuk ka shfaqur vullnetin për të qenë prezent në seancë dëgjimore.

Raporti analitik i përgatitur nga nëpunësi përgjegjës për vlerësimin është një raport i detajuar kështu që nuk do ndalem në përshkrimin dhe evidentimin e të gjitha të dhënave që burojnë nga burimet e vlerësimit, por në mënyrë më specifike do të ndalem në ato kritere ku nga ana ime si relatore është konstatuar shkallë jo shumë e lartë e aftësisë dhe për të cilat edhe gjyqtari ka bërë kundërshtimet e tij.

Lidhur me kriterin e parë të aftësive profesionale, aspekti i njohurive ligjore, treguesi 1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave. referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtari subjekt vlerësimi ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes dhe përshkrimin e tyre duke i ndërthurur me provat e administruara në gjykim. Ai ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim mbi faktin objekt shqyrtimi. Identifikimi dhe përcaktimi nga gjyqtari, në mënyrë të qartë i faktit juridik që përbën objektin e gjyqimit, orienton mënyrën e paraqitjes së fakteve, analizën e provave dhe analizën ligjore të çështjes në vijim të arsyetimit të vendimit, analizë e cila është e ndryshme në bazë të objektit të gjyqimit. Për këtë arsye kam propozuar shkallë shumë të lartë aftësie, pikët 25.

Për sa i përket treguesit të dytë të këtij aspekti që është 1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes, normat ligjore procedurale dhe materiale, identifikohen, interpretohen dhe aplikohen mbi faktin, në shërbim të konkluzionit të arritur nga gjyqtari në lidhje me zbatimin e tyre. Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përgjithësisht identifikimi i normës juridike (procedurale dhe materiale - civile apo penale) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga

gjqytari lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Tipar karakteristik i gjyqtarit është se në çdo rast citimi ose referimi i dispozitave është shoqëruar me interpretimin e tyre në mënyrë abstrakte dhe individuale, para aplikimit mbi faktin konkret ose konkluzionin e arritur. Konstatohet se gjyqtari kryesisht përdor interpretimin teleologjik të normës konkrete duke identifikuar qëllimin e saj, por edhe interpretimin literal apo sistematik të normave, interpretim i cili duke e përjasur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, sjell si pasojë logjike konkluzionin e tij në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Në projektraport evidentohen të gjitha vendimet gjyqësore ku spikat interpretimi i ligjit material të zbatueshëm, interpretimi i dispozitave procedurale civile dhe penale, zbatimi dhe evidentimi i parimeve të përgjithshme të së drejtës, apo edhe në ato raste kur gjyqtari ka përdorur jurisprudencën e Gjykatës së Lartë. Por veç tyre, në vendimin nr. 253/2022, konstatohet se interpretimi që gjyqtari i bën kompetencave të parashikuara në ligj për gjyqtarin e seancës paraprake, të parashikuara nga nenet 332/dh në lidhje me nenin 328 pika 1 të K.Pr.Penale, nuk përputhet me jurisprudencën relevante të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Pavarësisht se vlerësuesi nuk ndërhyr në bindjen e brendshme të gjyqtarit dhe mënyrën e interpretimit prej tij të ligjit të zbatueshëm, çka vlerësohet vetëm nga një gjykatë më e lartë, dukshëm konstaton në këtë vendim që jurisprudenca relevante e Gjykatës së Lartë mbi kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake kur shqyrton çështje me objekt: “Dërgim për gjyq”, nuk rezulton të gjejë zbatim. Në projektraport është përmendur edhe i gjithë arsyetimi që ka bërë gjyqtari i cili edhe pse ka pasur cilësinë e gjyqtarit të seancës paraprake, në fakt nga mënyra e arsyetimit, ka zgjidhur në themel çështjen për sa i përket fajësisë, përgjegjësisë penale të personit të akuzuar.

Arsyetimi i mësipërm mbi ligjin procedural të zbatueshëm dhe zberthimi që gjyqtari i bën elementëve të tij, çka ka orientuar më pas dhe disponimin e tij mbi çështjen në shqyrtim, duke marrë në thelb kompetencat e gjyqtarit të themelit, nuk përputhet me jurisprudencën relevante, konkretisht me qëndrimet e konsoliduara të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në disa vendime të cilat janë të cituara në projektraport dhe janë

vendime të vitit 2022 (janë vendime më të hershme se vendimi që ka dhënë gjyqtari i cili i përket dhjetorit të vitit 2022).

Në tërësi, në vendimet përfundimtare, përgjithësisht interpretimi i dispozitave ligjore, përveç analizës abstrakte dhe zbërthimit të kuptimit të tyre, para aplikimit mbi faktet konkrete, pasurohet me referimin në praktikën unifikuese/njësuese të Gjykatës së Lartë, si dhe në aplikimin e parimeve të së drejtës. Por e njëjta shkallë kujdesi nuk evidentohet në çështjen penale me objekt: “Dërgim në gjyq”, ku interpretimi i dispozitave ligjore e zbatimi i tyre mbi faktet objekt gjykimi, nuk mbështetet në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë mbi kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake e ndryshimin e tyre nga ato të gjyqtarit të themelit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, brenda treguesit të “Aftësisë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, vlerësohet gjithashtu aftësia e gjyqtarit për të analizuar jurisprudencën, duke u përqendruar tek aftësia për të kërkuar, identifikuar, organizuar dhe përdorur jurisprudencën relevante për një çështje të caktuar. Në veçanti vlerësohet nëse gjyqtari i referohet dhe menaxhon me efikasitet, në vendin e duhur dhe sipas llojit të qëllimit të aktit, praktikën e konsoliduar gjyqësore, etj.

Duke vlerësuar në tërësi metodologjinë e punës së gjyqtarit dhe aftësinë e tij në drejtim të kërkimit, gjetjes dhe përdorimit të jurisprudencës relevante, nuk rezulton e njëjta shkallë kujdesi në të gjitha vendimet gjyqësore të analizuara, çka e bën aftësinë e tij për këtë tregues të jetë e shkallës “Mbi mesatare”. Për këtë arsye kam propozuar pikëzimin me 20 pikë.

Lidhur me këtë tregues gjyqtari ka paraqitur kundërshtimet e tij duke kërkuar që të vlerësohet në shkallë shumë të lartë aftësie, me pretendimin se: “Përfundimi i arritur nga ana e relatorit bazohet vetëm në një dosje gjyqësore, ndërkohë që ka shumë të tilla prandaj vlerësimi i nivelit mbi mesatare nuk është i drejtë. Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, duke filluar nga neni 332 e vijues i tij janë shtuar e ndryshuar në vitin 2017 dhe 2021, çka mendoj që ka sjellë vështirësi kuptimi dhe interpretimi për të gjithë gjyqtarët.

Mungesa e qëndrimit njësuës të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në lidhje me të drejtën ligjore të gjyqtarit të seancës paraprake, për të vendosur pushimin e akuzës apo çështjes dhe raportin me gjyqtarin e themelit, është një çështje që ka ndikuar.

Gjithashtu, në të njëjtën kohë kam gjykuar edhe shumë çështje të fushave civile dhe administrative.”

Lidhur me kundërshtimet e gjyqtarit të vilat në thelb vlerësoj që nuk është se qëndrojnë në ndryshimin e shkallës së aftësisë së gjyqtarit, dua të theksoj se pavarësisht se bëhet fjalë për një vendim me objekt “Dërgim çështje për gjyq”, në fakt ne gjatë vlerësimit marrim modele vendimesh për të gjitha llojet e gjykuara nga gjyqtari, dhe pse është një çështje e vetme, kjo tregon mënyrën se si gjyqtari interpreton në të gjitha rastet kompetencat e gjyqtarit të hetimit paraprak. Nga ana tjetër, në momentin kur është dhënë vendimi dhe kur është shqyrtuar çështja, ka pasur një praktikë të konsoliduar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë lidhur me kompetencat e gjyqtarit të hetimit paraprak, duke bërë dallimin se deri ku shkon kompetenca e tyre krahasuar me gjyqtarin e themelit. Kështu që nuk qëndron pretendimi që duhet të ketë një vendim njësoj. Vendimi njësoj është kur kemi vendime të ndryshme të dy kolegjeve. Praktika e konsoliduar e Gjykatës së Lartë është e detyrueshme për ta evidentuar dhe për ta zbatuar nga ana e gjyqtarit.

Gjithashtu pretendimi që ka gjykuar çështje të llojeve të ndryshme, nuk qëndron sepse çdo çështje i duhet dhënë rëndësia e duhur dhe nga ana tjetër ky kriter bën fjalë për mënyrën e interpretimit të ligjit të zbatueshëm lidhur me zgjidhjen e çështjes, për këtë arsye, pavarësisht kundërshtimeve nga ana e gjyqtarit, unë si relatore nuk kam ndryshim të qëndrimit lidhur me shkallën e aftësisë dhe pikëzimin e gjyqtarit. Përfundimisht i qëndroj shkallës së aftësisë mbi mesatare duke u pikëzuar me 20 pikë.

Për sa i përket 1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit. Lidhur me këtë tregues ka disa gjetje, që kanë rezultuar nga leximi i të gjitha dokumenteve ligjore, që janë vendimet gjyqësore.

Përgjithësisht gjuha e përdorur nga gjyqtari në komunikimin me palët gjatë gjykimit dhe në aktet procedurale të dosjeve të analizuar është në çdo rast e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, e qartë për palët në proces, si dhe për lexuesin e akteve. Gjyqtari përdor të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe, respekton rregullat gramatikore, ndërtimin e paragrafëve. Përdor fjali me gjatësi mesatare, të strukturuar dhe në rrjedhë logjike të njëra tjetrës. Mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit në arsyetimin e vendimeve, përgjithësisht tregon qartësinë dhe vijueshmërinë e mendimit duke i bërë vendimet të kuptueshme. Por lidhur me këtë tregues, një nga komponentët që vlerësuesi bën ose

vlërëson lidhur me aftësinë e gjyqtarit është ai i përdorimit të kujdesshëm të gjuhës në hartimin e vendimeve gjyqësore. Në një nga vendimet gjyqësore i cili evidentohet në projektraport, ku gjyqtari disponon “për parashtrimin e mosmarrëveshjes në lidhje me kompetencën tokësore” në Gjykatën e Lartë, ai shprehet: “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë çmon se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që kryesisht ka shpallur moskompetencën tokësore për shqyrtimin e çështjes, është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit. Ajo gjykatë në arsyetimin e vendimit ka marrë kryesisht në shqyrtim faktin nëse është kompetente nga pikëpamja tokësore për shqyrtimin e çështjes objekt gjykimi apo jo, pa patur kërkesë nga pala kërkuese”.

Pavarësisht mendimit të gjyqtarit, interpretimit të ligjit dhe bindjes së brendshme të gjyqtarit lidhur me gjykatën kompetente, kur janë gjykata të të njëjtit nivel, gjyqtari i shkallës së parë duhet të tregohet i kujdesshëm në mënyrën e të shkruarit në vendimin gjyqësor dhe në përzgjedhjen e fjalëve, pa bërë ai vetë gjykatën më të lartë. Në këtë rast togfjalëshi i përdorur “është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit...” për gjykatën e të njëjtit nivel, nuk tregon përzgjedhje të kujdesshme të gjuhës nga gjyqtari për kolegun e gjykatës tjetër i cili që ka shpallur moskompetencën, pavarësisht qëndrimit të Gjykatës së Lartë lidhur me mosmarrëveshjen që krijohet mes dy gjykatave në rastin konkret. Gjyqtari i shkallës së parë në këtë rast duhet të shprehet në mënyrë të tillë që të tregojë respekt për mendimin e kolegut, pavarësisht se vetë ai mund të ndajë qëndrim të ndryshëm, shkak për të cilin i drejtohet Gjykatës së Lartë për të zgjidhur mosmarrëveshjen e kompetencës. Vetëm kjo e fundit mund të vendosë se cili nga vendimet është apo jo i bazuar në ligj.

Gjithashtu, në drejtim të qartësisë së disponimeve në dispozitivin e vendimit” konstatohet që në një vendim tjetër, pavarësisht se në pjesë arsyetuese gjyqtari ka shpjeguar arsyet pse ka pranuar pretendimin e pagimit të kamatëvonesave për faturat tatimore të palikujduara në kohë, duke parashikuar kohën e fillimit të pagimit të tyre për çdo faturë si dhe mënyrën e llogaritjes, në dispozitivin e vendimit, i cili duhet të tregojë qartë çdo detyrim të palës së paditur, nuk gjendet e shkruar në mënyrë të qartë ajo çka është pasqyruar në arsyetim dhe as momenti deri kur nga përmbaruesi duhet të llogariten këto kamatëvonesa. Ka mbetur thjesht si një shprehje në dispozitiv, pra pa e bërë detyrimin e qartë dhe të përcaktuar për t’u ekzekutuar. Ka edhe një element tjetër në

drejtim të koncizitetit që evidentohet pothuajse në vendimet të një natyre më komplekse, vendime të zgjedhura nga ana e gjyqtarit, konstatohet lehtësisht se tek mënyra e të shkruarit zgjatja e mendimit tek pjesa përshkruese, kryesisht tek pasqyrimi i pretendimeve të palëve. Këto të fundit në shumicën e rasteve nuk përmbledhen, madje disa herë pasqyrohen në vetën e parë. Kujdesi që gjyqtari tregon në pasqyrimin e të gjitha pretendimeve të palëve mbingarkon pjesën përshkruese të vendimit, me përsëritje faktesh apo rikthim në prova që janë pasqyruar një herë tek paraqitja e fakteve të çështjes. Gjyqtari duhet të tregojë aftësi në paraqitjen e përmbledhur të pretendimeve të palëve sepse gjithëpërfshirja dhe saktësia e paraqitjes së çdo pretendimi nuk nënkupton ricitim në vendim të gjithë përmbajtjes së diskutimit përfundimtar të palëve.

Për këtë arsye, lidhur me këtë tregues kam vlerësuar se gjyqtari ka aftësi të lartë në drejtim të kuptueshmërisë së vendimit por e njëjta aftësi nuk evidentohet në drejtim të “përzgjedhjes së kujdesshme të gjuhës” “qartësisë së disponimeve në dispozitivin e vendimit” dhe “koncizitetit të pjesës përshkruese, nëndarjes pretendimet e palëve”. Theksimi i tepruar i hollësive dhe tendenca për të pasqyruar në vendim çdo diskutim të palëve, zbeh evidentimin e çështjeve që kanë përbërë thelbin e pretendimeve objekt padie apo prapësimeve në gjykim. Për këtë arsye kam vlerësuar shkallë aftësie “mbi mesatare”, duke u pikëzuar me 12 pikë.

Lidhur me këtë tregues gjyqtari, ka paraqitur kundërshtime por lidhur vetëm një gjetje që i është bërë, konkretisht për sa i përket përzgjedhjes jo të kujdesshme të gjuhës ku ka shpjeguar se nga ana ime i togfjalëshit “është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit”, ka lidhje me dispozitën ligjore konkrete procedurale ku përcaktohet se çështja e kompetencës nuk merret në shqyrtim kryesisht nga gjykata. Gjithashtu, togfjalëshi i sipërcituar i përdorur nga ana ime nuk mendoj se është relevant për kategorinë e vlerësuar: qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit. Vetëm këtë pjesë ka kundërshtuar. Nuk ka kundërshtuar pjesën e koncizitetit, pjesës përshkruese dhe pjesën e saktësisë në disponim.

Pavarësisht kundërshtimeve të gjyqtarit unë vazhdoj të mbaj të njëjtin qëndrim sikundër kam propozuar në këtë projektraport vlerësimi. Propozimi shkallë aftësie “mbi mesatare”, pikëzimi 12 pikë.

Për sa i përket treguesit tjetër 1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit. Në tërësi, referuar të dhënave rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit e cila është e dukshme në aspektin vizual dhe të përmbajtjes. Ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecures logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e vendimeve. Shkallë shumë e lartë aftësie. Pikëzimi me 10 pikë.

Për sa i përket treguesit të fundit që është 1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik, në cilësinë e relatores kam vlerësuar se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes, analizë e cila në vendimet e themelit është e detajuar dhe e plotë, duke integruar si pjesë të saj, provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni i gjyqtarit. Veç procesit analitik të provave, spikat aftësia e gjyqtarit në interpretimin dhe zërthimin e dispozitave ligjore dhe i praktikës gjyqësore. Por edhe pse analiza e detajuar e provave dhe interpretimi i ligjit është pjesë e rëndësishme e arsytimit të vendimit gjyqësor në tërësi, ajo nuk është e mjaftueshme për të gjykuar mbi cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik. Nëse ajo nuk shoqërohet me të njëjtën shkallë kujdesi me analizën se si konceptet ligjore dhe institutet lidhen midis tyre apo se si ato zbatohen në një situatë të caktuar (faktet e provuara), argumentimi logjik nuk është shterues. Në dokumentet ligjorë spikat aftësia e gjyqtarit në drejtim të analizës së provave dhe interpretimit të ligjit, madje të dy këta komponentë zënë peshën më të madhe të arsytimit të vendimeve, analizë që bazohet në arsye dhe logjikë. E njëjta rrjedhë logjike dhe cilësi analitike nuk spikat në çdo rast kur analizohet zbatimi i dispozitës mbi faktet e provuara, e cila është ajo që lidhet drejtpërdrejt me konkluzionin e arritur. Në vendimet gjyqësore nuk ka një ekuilibër midis pjesës përshkruese dhe asaj analitike, duke mos i dhënë më shumë rëndësi kësaj të fundit. Gjyqtari nuk është për të përshkruar, por për të analizuar dhe vlerësuar. Peshën më të madhe në vendim duhet ta zërë pikërisht komponenti analitik, prandaj sasia e arsytimit duhet të mbizotërohet nga pjesa analitike dhe argumentimi logjik se si dispozitat e interpretuara në mënyrë abstrakte dhe praktika gjyqësore zbatohet mbi faktet konkrete.

Për sa i përket këtij kriteri duke analizuar metodologjinë e punës së përgjithshme të gjyqtarit në të gjitha llojet e çështjeve të përzgjedhura, pa i dhënë peshë dhe rëndësi

të veçantë asnjërës prej tyre, kam vlerësuar që shkalla e aftësisë së gjyqtarit duhet të vlerësohet mbi mesatare duke u pikëzuar me 20 pikë.

Edhe në këtë tregues, gjyqtari ka paraqitur kundërshtimet e tij, duke pretenduar se për mendimin e tij duhet të vlerësohen të dyja aftësitë e gjyqtarit, paraqitja dhe analiza e çështjes me shkallën e aftësisë së procesit analitik të provuarit të fakteve. Në të gjitha vendimet gjyqësore ai ka evidentuar drejt faktet dhe rrethanat e çështjes, të drejtën e zbatueshme, pretendimet dhe prapësimet e palëve, dhënie përgjigje argumentuese përkundrejt pretendimeve dhe prapësimeve, peshën e tyre dhe ballafaqimin me ligjin. Për këtë arsye pretendon që duhet të ketë shkallë shumë të lartë aftësie, pikëzimi me 25 pikë.

Në cilësinë time si relatore unë ndaj të njëjtin qëndrim sepse edhe pse cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin fakt, normë, interpretim ligjor, konkluzion, nuk reflektohet e njëjta shkallë kujdesi në lidhje me argumentimin logjik se si dispozitat zbatohen mbi faktet e provuara, që është dhe pjesa më e rëndësishme e vendimit gjyqësor. Për këtë arsye kam propozuar që niveli i vlerësimit të jetë “mbi mesatar”.

Përfundimisht për kriterin e parë të aftësive profesionale të gjyqtarit propozoj nivel vlerësimi “Shumë mirë”, pikët 87.

Për sa i përket kriterit të dytë “Aftësitë organizative të gjyqtarit”, 2.A.a Respektimi i afateve ligjore, referuar të gjitha të dhënave duhet të theksoj se gjyqtari për këtë periudhë ka punuar në dy gjykata, në Gjykatën Administrative të shkallës së Parë Shkodër dhe në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Pukë dhe të dhënat statistikore janë punuar për të dyja gjykatat.

Në total për vitin 2022, ai ka gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë 32 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor, nga të cilat 11 prej tyre janë jashtë afatit dhe 110 çështje me standard minimal. Në total ka gjykuar për vitin 2022 142 çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.

Për sa i përket Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër ka gjykuar 4 çështje në tërësinë e çështjeve për të cilat ka pasur të parashikuar afat ligjor dhe të katra çështjet janë të shqyrtuara tej këtij afati, ndërkohë që ka gjykuar edhe 99 çështje me standard minimal, pra vetëm 103 çështje.

Në analizë tërësore të të dhënave statistikore rezulton se nga 32 çështje të gjykuara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe 4 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, 15 janë gjykuar jashtë afatit, përqindje që sipas metodologjisë përkon me 41.6% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Nga ana ime si relatore është bërë analiza e të dhënave statistikore në mënyrë logjike në mënyrë që të shmangim përfundime që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, duke marrë parasysh të gjitha të dhënat e burimeve të vlerësimit dhe nga një llogaritje matematikore duke përjashtuar për shembull periudhën e fundvitit ose periudhën e lejes vjetore apo edhe ato raste kur tejkalimet kanë qenë vonesa të papërfillshme një apo dy ditë, ka rezultuar se nga 15 çështje, 6 duhet të konsiderohen në afat (tejkalimi ka qenë i papërfillshëm), ndërkohë që përqindja rezulton përsëri rreth 25%, 9 çështje nga 36 të shqyrtuara tej afatit, përqindje e cila sipas metodologjisë përkon me nivelin e vlerësimit prej 9 (nëntë) pikësh.

Ndërkohë dua të theksoj që Kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë në mendimin e saj e ka vlerësuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të këtij treguesi si “shumë të lartë”, ndërsa ajo e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër e ka konsideruar si “mbi mesatare”.

Në tërësi, duke iu referuar analizës matematikore dhe logjike të të dhënave statistikore: a) numrit të ulët të çështjeve të shqyrtuara, të cilat llogariten me afat ligjor (36 çështje), çka sjell përqindje të lartë të raportit të çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor me numrin e çështjeve për të cilat ligji parashikon afat ligjor; - pra kemi 15 çështje në 36 të shqyrtuara; b) pamundësinë e respektimit në të gjitha rastet të afatit ligjor 20-ditor sipas nenit 610 të K.Pr.Civile, në rastet e gjykimit administrativ, ku për shkak të procedurës duhet të respektohen edhe të drejtat dhe detyrat procedurale të organit publik; c) faktit që gjatë pesëmuajorit të parë të periudhës së vlerësimit (01.01.2022 – 31.12.2022) gjyqtari ka ushtruar njëkohësisht detyrën në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, kam vlerësuar që për këtë tregues, gjyqtari pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi se ai që i përket përqindjes së çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit, pavarësisht se përqindja e çështjeve të shqyrtuara rezulton 25%. Por gjyqtari nuk mund të pikëzohet maksimalisht, pasi pavarësisht ekzistencës së rrethanave objektive të pasqyruara nga ana e gjyqtarit në formularin e

integruar, duhet t'i kishte kushtuar një rëndësi të veçantë dhe parësore çështjeve me afat ligjor, të cilat për shkak të rëndësisë së tyre duhet të gjykohen jo brenda afateve të arsyeshme, por brenda afateve të përcaktuara shprehimisht nga ligji procedural përkatës. Për këtë shkak kam propozuar pikëzimin me 12 pikë.

Lidhur me këtë tregues gjyqtari ka paraqitur kundërshtime, por ai bën analizë të të dhënave statistikore bazuar në afatin e arsyeshëm sipas neneve të K.Pr.C. që bën fjalë për gjykimet tej afateve të arsyeshme. Në fakt ky tregues nuk mat aftësinë e gjyqtarit për respektimin apo jo të afatit të arsyeshëm por aftësinë e gjyqtarit për respektimin e afatit ligjor. Afatet e arsyeshme dhe afatet ligjore janë dy koncepte të ndryshme të parashikuar në ligj. Fakti që gjyqtari nuk e ka kaluar afatin e arsyeshëm apo e ka kaluar në një masë shumë të vogël, rreth 6%, është një tregues që mund të çojë në rritjen e pikëzimit, sikundër unë e kam aplikuar në rastin konkret, por nuk çon në një pikëzim maksimal të gjyqtarit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, respektimit i afateve ligjore nënkupton respektimin nga ana e gjyqtarit të afateve të parashikuara në ligj. Ndërkohë që neni 399/2 i K.Pr.Civile, i referuar nga gjyqtari si përcaktim i afatit brenda të cilit duhet të shqyrtohet çështja, është i gabuar në rastin konkret, pasi kjo dispozitë parashikon mjetet juridike për t'u mbrojtur nga cenimi i së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm dhe nuk lidhet me afatet ligjore të përcaktuara në ligj. Për këtë arsye vazhdoj t'i qëndroj propozimit që duhet të pikëzohet me 12 pikë.

Për sa i përket 2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore, përsëri janë analizuar të dhënat statistikore në gjykatën e rrethit gjyqësor Pukë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, sipas raportit analitik, ka rezultuar 32.7% të çështjeve të gjykuara jashtë afatit standard minimal, ndërkohë që në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, duke marrë parasysh afatin 87-ditor që ne zbatojmë lidhur me çështjet, ka rezultuar 72 çështje të gjykuara tej afateve standard.

Në tërësi, duke marrë të dhënat e të dyja gjykatave, në një analizë tërësore, rezulton të jenë gjykuar tej standardeve 63,1% e çështjeve.

Pas analizës logjike të të dhënave statistikore duke përfshirë periudhën e lejes vjetore, periudhën e fundvitit, tejkalimet me një apo dy ditë të cilat janë tejkalime të

papërfillshme, përsëri përqindja mbetet shumë e lartë 60.2% të gjykuar jashtë standardit minimal në fuqi.

Të dyja kryetaret e gjykatave në detyrë (Pukë dhe administrative Shkodër) në fakt kanë dhënë të dyja të njëjtin mendim duke vlerësuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të këtij treguesi si mesatare. Në fakt edhe vetë gjyqtari të njëjtën aftësi e ka vlerësuar veten si mesatare.

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: a) afatin e gjykimit të çështjeve administrative për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, duke pranuar si të tillë atë 87-ditor; b) raportin e çështjeve të gjykuara tej afatit standard, me numrin total të çështjeve, i cili rezulton të jetë në masën 60.2%; c) shkaqet që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit, ku gjyqtari në tërësi ka gjykuar në dy gjykata, madje ai ka evidentuar se në të njëjtën ditë ka ushtruar funksionin në të dyja gjykatat njëkohësisht; d) mendimin e dy kryetarëve të gjykatave respektive ku gjyqtari ka ushtruar detyrën të cilët e vlerësojnë shkallën e aftësisë së gjyqtarit si “mesatare”, e njëjtë kjo me shkallën e aftësisë që dhe vetë gjyqtari ka vetë vlerësuar veten e tij; e) natyrën orientuese dhe jo detyruese të këtyre standardeve kohore, ku hapësira e vlerësuesit është me e gjerë se treguesi i “Respektimit të afateve ligjore”; pavarësisht përqindjes së mësipërme, e cila sipas metodologjisë pikëzohet me 1 pikë, kam vlerësuar se gjyqtari duhet të pikëzohet me një nivel me të lartë, me 2 pikë sepse ngarkesa totale e punës, pavarësisht se për 5 muajt e parë të vitit 2022 ai me vullnetin e tij është caktuar për të gjykuar në dy gjykatat si më sipër, nuk justifikon zbatimin e një shkalle më të lartë pikëzimi në rastin konkret, pasi në total në të dyja gjykatat, për një vit ka gjykuar vetëm 245 çështje nga të cilat çështje me palë kundërshtarë janë vetëm 145, nën standardin sasior prej 200 çështjesh themeli. Për këtë arsye kam propozuar shkallë aftësie nën mesatare dhe pikëzimi me 2 pikë për “Plotësimi i standardeve minimale kohore”.

Gjyqtari lidhur me këtë tregues, ka paraqitur disa prova kryesisht të cilat kanë të bëjnë me disa publikime “online” lidhur me kushtet e motit në ditët e para të janarit dhe shkurtit të vitit 2022; ka paraqitur të dhëna lidhur me ngarkesën dhe shortet manuale që janë zhvilluar në gjykatën e Pukës gjatë vitit 2021. Ka paraqitur të dhëna lidhur me ngarkesën në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër lidhur me mbartjet

e gjykimeve që ka pasur nga 2021 në vitin 2022, por këto të gjitha janë tregues dhe janë analizuar në projektraport vlerësimi sepse kanë qenë të dhëna që kanë rezultuar nga analizat statistikore. Në fakt, ka paraqitur veç tyre edhe një raport mjekësor që ka të bëjë me ditët e para të muajit janar dhe gjatë kësaj kohe gjyqtari ka qenë edhe me leje vjetore dhe e njëjta periudhë njëkohësisht i është marrë parasysh edhe për mbajtjen e dosjeve, kështu që edhe pse janë analizuar edhe një herë të dhënat statistikore, kjo periudhë nuk rezulton që të ketë afektuar në një analizë të ndryshme. Vetëm një çështje në fakt rezulton që të jetë ndikuar nga kjo periudha e lejes së gjyqtarit, që ka qenë fund dhjetori mes janari i vitit 2022, dhe përsëri edhe me një llogaritje matematikore, përqindja del shumë e lartë rreth 59,8% e çështjeve të gjykuara jashtë standardit, çka që nuk mund të çojë në një shkallë më të lartë pikëzimi se ai i pretenduar nga gjyqtari. Si relatore, nuk kam ndryshim për propozimin tim lidhur me këtë tregues. Pra shkalla e aftësisë nën mesatare, pikëzimi me 2 pikë.

Për sa i përket treguesit tjetër 2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, nuk ka kundërshtime. Vijon të ekzistojë e njëjta logjikë e analizës së të dhënave statistikore dhe kam propozuar pikëzimin me 3 pikë duke u bazuar edhe në vetëvlerësimin e gjyqtarit dhe në vlerësimin që kryetarët në detyrë i kanë bërë aftësisë së gjyqtarit lidhur me këtë tregues. Gjyqtari nuk ka kundërshtime.

Rendimenti në fakt ka rezultuar 102.9%, çka tregon ngarkesën e ulët në vitin 2022 për çështjet e reja dhe është pikëzuar me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, rezulton që të jetë më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve. Pikëzimi 15 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore. Kanë dalë 2.5 seanca në çështjet civile, 2 seanca në çështjet familjare, 3 seanca paraprake dhe 1 në çështjet administrative me palë. Numri mesatar 2,2 seanca dhe shkallë aftësie në shmangien e seancave gjyqësore joproductive.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, në tërësi referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për

zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit me efikasitet dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse. Kohëzgjatja e gjykimeve në tërësi tej afateve standarde orientuese nuk duket të jetë ndikuar nga administrimi i efikasitetit të procesit, por nga lënia përgjithësisht e seancave në distanca kohore të gjata, pra jo se gjyqtari nuk administron mirë procesin por se seancat gjyqësore lihen në një kohë shumë të gjatë dhe kjo sjell zgjatje të afatit, çka ka ndikuar në pikësimin e treguesit “Plotësia e standardeve minimale kohore” dhe “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje”.

Për sa i përket 2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes dhe 2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes, ka shkallë shumë të lartë të aftësisë me pikëzimin maksimal për secilin nga këta tregues.

Përfundimisht për kriterin e dytë të aftësive organizative, propozimi im si relacion është niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm” dhe pikët 92.

Për kriterin e tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” nuk ka pasur asnjë ankesë të depozituar në ILD për këtë periudhë, nuk ka pasur masa disiplinore. Të dy kryetarët e gjykatave, për të gjithë treguesit e këtij kriteri e kanë vlerësuar shumë të lartë shkallën e aftësisë së gjyqtarit. Për këtë arsye, për të gjithë treguesit që bëjnë fjalë për etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, 3.A Etika në punë, 3.B Integriteti i gjyqtarit, 3.C Paanësia e gjyqtarit, 3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese, shkalla e aftësisë së gjyqtarit është shumë e lartë, pikëzimi maksimal, 100. Edhe nga ILDKPKI-ja në raportin e përcjellë, nuk është konstatuar ndonjë rast i konfliktit të interesit.

Për sa i përket “Aftësisë personale dhe angazhimi profesional”, ka shkallë shumë të lartë të aftësisë tek 4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent, 4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale (Nuk ka pasur të dhëna që mund të afektonin këto tregues, kryesisht bazohemi këtu tek mendimi i kryetarit të gjykatës në formularin e vetëvlerësimit); 4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta si dhe 4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore. Gjyqtari ka qenë i përfshirë në trajnimin vazhdues. Ka marrë pjesë në 6 aktivitete të shtrira në 6.5 ditë trajnimi brenda vitit 2022, çka sjell pikëzimin me 20 pikë sipas metodologjisë.

Për sa i përket 4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve, 4.C.c Pjesëmarrja

e gjyqtarit në veprimtari ndërinstucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata si dhe për 4.C.ç Publikimet ligjore akademike nuk ka të dhëna prandaj është vlerësuar me 3 – 3 – 0 pikë.

Pëfundimisht për kriterin e fundit “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, pikëzimi është 91, “Shkëlqyeshëm”.

Gjyqtari ka paraqitur kundërshtime për sa i përket treguesit të “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e tyre, duke deklaruar se nuk ka qenë në listat e gjyqtarëve udhëheqës në praktikën profesionale të kandidatëve për gjyqtarë por ai ka aplikuar pranë Shkollës së Magjistraturës për lehtësues duke dërguar edhe dokumentacionin e kërkuar nga shkolla.

Pavarësisht deklarimeve të gjyqtarit, qëllimi i metodologjisë për këto tregues ka qenë i tillë që me dy pikë shtesë do të vlerësohet kontributi efektiv që gjyqtarët japin lidhur me trajnimet e gjyqtarëve apo në rastet e mentorimeve. Kështu që, pavarësisht kundërshtimeve të gjyqtarit, pikëzimi për këtë tregues do vazhdojë të jetë 3 pikë sepse nuk provohet që të ketë dhënë kontribut efektiv lidhur me këto tregues.

Pëfundimisht për sa i përket nivelit të përgjithshëm të vlerësimit dhe nivelit të përgjithshëm për çdo kriter vlerësimi, kam propozuar për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarit”, 87 pikë, niveli i vlerësimit “Shumë mirë”, për “Aftësitë organizative”, 92 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, 100 pikë, “Shkëlqyeshëm”, “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, 91 pikë, “Shkëlqyeshëm”. Niveli i përgjithshëm i vlerësimit është “Shumë mirë” dhe pikët 370.

Janë përpiluar edhe propozimet dhe rekomandimet përkatëse në përfundim të projektraportit duke rekomanduar që gjyqtari veç angazhimit e tij të vazhdueshëm në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore, duhet t’i kushtojë më shumë rëndësi respektimit të standardeve minimale kohore, përzgjedhjes së kujdesshme të gjuhës në arsyetimin e vendimeve, saktësisë së dispozitivit të vendimit me qëllim që ai të jetë i qartë dhe i zbatueshëm, si dhe përditësimit me praktikën e konsoliduar të Gjykatës së Lartë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit! Atëherë, fjalën e kanë kolegët nëse kanë ndonjë diskutim. Po, zoti Hallunaj!

Dritan Hallunaj: Jam njohur me materialin e paraqitur për vlerësimin e gjyqtarit {...} dhe pasur parasysh bekgraundin e tij, punën e tij që ka pasur në dy gjykata (Pukë dhe administrative Shkodër), por edhe vendbanimin e tij që qenka në Lezhë, si dhe rrethanat e tjera për të cilat unë nuk dua t'i përsëris këtu për efekt kohe, propozoj që në treguesin “Njohuritë ligjore”, “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, duke pasur parasysh që për mendimin tim shkalla e aftësisë së gjyqtarit është shumë e lartë, propozoj që të jetë nga 20 në 25 pikë. Në këtë kuadër edhe në “Cilësinë e analizës dhe argumentit ligjor” që është mbi mesatare, unë propozoj që të jetë shumë e lartë, me 25 pikë. Për të tjerat jam plotësisht dakord me sa u relatua. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim nga kolegët?

Brikena Ukperaj: Duke respektuar mendimin e zotit Hallunaj, në fakt arsyeja pse gjyqtari është vlerësuar me shkallë aftësie mbi mesatare tek interpretimi i ligjit mbi faktet e çështjes, ka qenë pikërisht mosevidentimi dhe mospërditësimi me praktikën e konsoliduar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Nëse do të vazhdojmë t'i qëndrojmë këtij propozimi, kjo gjë duhet të reflektohet edhe në arsyetim. Pra a mendoni se kjo përbën një gjetje për gjyqtarin? Se nëse kjo përbën një gjetje për gjyqtarin, ne duhet ta përkthejmë në pikëzim. Nëse nuk përbën gjetje për gjyqtarin ky fakt, atëherë dakord.

Naureda Llagami: Zbatojmë procedurën. Kalojmë në votim propozimin e parë, që ka të bëjë me treguesin e “Aftësisë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjeve”, ku sugjerohet rritja e 5 pikëve, nga 20 në 25 pikë.

Ilir Rusi: Kundër.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Kundër.
Fatmira Luli: Dakord.
Marçela Shehu: Dakord.
Yllka Rupa: Kundër.
Brikena Ukperaj: Kundër.
Klodian Kurushi: Dakord.
Naureda Llagami: Kundër.

Naureda Llagami: Kalojmë në propozimin e dytë mbi “Cilësinë e analizës dhe argumentit logjik”, nëse do i rrisim 5 pikë, sipas propozimit të bërë nga zoti Hallunaj.

Ilir Rusi: Kundër.
Irena Plaku: Kundër.
Dritan Hallunaj: Pro.
Ridvan Hado: Dakord.
Alban Toro: Kundër.
Fatmira Luli: Dakord.
Marçela Shehu: Dakord.
Yllka Rupa: Kundër.
Brikena Ukperaj: Kundër.
Klodian Kurushi: Kundër.
Naureda Llagami: Kundër.
Nuk kalon.

Naureda Llagami: Kalojmë në tërësi raportin sipas propozimit të ardhur nga relatorja.

Ilir Rusi: Dakord.
Irena Plaku: Pro.
Dritan Hallunaj: Pro.
Ridvan Hado: Dakord.
Alban Toro: Dakord.
Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë miratohet sipas propozimit të relatorit raporti i vlerësimit për zotin {...}.

* * *

(Pika 42 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.07.2023)

Pika 43 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën 2017 – 2019, relatore znj. Brikena Ukperaj.³

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:27 dhe mbaroi në orën 12:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|---------------------------------|
| 1. Naureda Llagami | <i>(kryetare)</i> |
| 2. Ilir Rusi | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 3. Klodian Kurushi | <i>(anëtar)</i> |
| 4. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 5. Irena Plaku | <i>(anëtare)</i> |
| 6. Dritan Hallunaj | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Ridvan Hado | <i>(anëtar)</i> |
| 8. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |
| 9. Marçela Shehu | <i>(anëtare)</i> |
| 10. Brikena Ukperaj | <i>(anëtare)</i> |
| 11. Yllka Rupa | <i>(anëtare)</i> |

³ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej si pike e 42 sipas rendit të ditës.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

7. Edmond Hoxhaj (BIRN).

RENDI I DITËS:

43. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017-2019, relatore znj. Brikena Ukperaj.

Naureda Llagami: Kalojmë pa humbur kohë tek vlerësimi i radhës që ka të bëjë me gjyqtaren {...} për periudhën 2017 – 2019. Të lutem për efekt kohe shkurtimisht, duke qenë se s’kemi edhe kundërshtime nga ana e gjyqtares.

Brikena Ukperaj: Atëherë, gjyqtarja {...} ka qenë pjesë e programit të vlerësimit dhe është vlerësuar për periudhën 2017 – 2019. Ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe ky projektraport është me qëllim gradimin e gjyqtares.

Projektraporti i është njoftuar gjyqtares dhe iu është dërguar në adresën elektronike të gjithë anëtarëve, kështu që, duke qenë se gjyqtarja nuk ka paraqitur kundërshtime, po ndalem shkurtimisht vetëm në konkluzionet e mia si relatore për çdo tregues të katër kritereve të vlerësimit.

Për sa i përket kriterit të parë të aftësive profesionale të gjyqtares, treguesi 1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, është evidentuar shkallë shumë e lartë të aftësisë në drejtim të këtij treguesi dhe shkalla e pikëzimit me 25 pikë.

Për sa i përket treguesit 1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes, shkallë shumë e lartë e aftësisë së gjyqtares. Në të gjitha vendimet burim vlerësimi evidentohet interpretimi i ligjit procedural dhe material në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes, identifikimi dhe zbatimi i praktikës relevante gjyqësore pastaj njësuese dhe praktikës së Gjykatës Kushtetuese. Shkallë shumë e lartë aftësie, 25 pikë.

Për sa i përket 1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit. Shkallë shumë e lartë e aftësisë. Rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të këtij treguesi, si në drejtim të kuptueshmërisë dhe kryesisht pjesës së koncizitetit të pjesës përshkruese, duke i dhënë peshë më të madhe asaj analitike. 15 pikë.

Ka një strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit. Një metodë të qartë të strukturimit si në aspektin vizual ashtu edhe në atë përmbajtjesor. Shkallë shumë e lartë aftësie. 10 pikë.

Për sa i përket treguesit të fundit rezulton që të ketë shkallë të lartë të aftësisë për sa i përket shkallës së analizës dhe argumentimit logjik. Arsytimi i vendimit është i plotë, i qartë dhe është gjithëpërfshirës për sa i përket çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural e thelbësor.

Kështu që, për kriterin e parë propozohet nivel shumë i lartë i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për sa i përket kriterit "Aftësive organizative", pas analizës logjike dhe matematikore të të dhënave statistikore ka rezultuar vetëm 14.6% e çështjeve që parashikojnë afat ligjor të shqyrtuara tej këtij të fundit. Ndërkohë që ka gjykuar në total 1593 çështje për tre vite, nga të cilat 856 çështje me palë kundërshtarë.

Duke marrë parasysh të gjitha të dhënat si dhe kalimin vetëm me 4.6% të pragut dhe ngarkesën tepër të lartë të çështjeve me afat ligjor të cilat zënë rreth 31% të shqyrtuara në total, kam vlerësuar shkallë shumë të lartë aftësie dhe pikëzimi me 15 pikë.

Për sa i përket 2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore, gjatë gjithë periudhës trevjeçare 1100 çështje kanë qenë me standard minimal. Është bërë analizë logjike dhe matematikore e të gjitha të dhënave dhe ka rezultuar rreth 23.97% por ndërkohë ka një tejkalim shumë të lartë të standardit minimal sasior për çështjet e

gjykuara, rreth 856 çështje me palë kundërshtare (më shumë se 100% të tejkaluar). Për këtë arsye kam propozuar pikëzimin me 5 pikë.

Për sa i përket treguesit tjetër 2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, ka rezultuar koha më e shkurtër ose e barabartë me standardin minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, duke e pikëzuar me 5 pikë. Është bërë analizë matematikore logjike dhe është propozuar rritja me një nivel pikëzimi për shkak të ngarkesës së gjyqtarës.

Në rendiment ka rezultuar rendimenti 94.76%, por duke qenë se ka tejkalim mbi 50% të standardit sasior, është propozuar rritja me një nivel. Ka 737 çështje të shqyrtuara pa palë kundërshtare dhe gjithë pjesën tjetër e ka çështje me palë kundërshtare.

Për sa i përket 2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit, rezulton që të jetë më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve. Në këtë rast ka një tejkalim për një kategori çka ka sjellë një rritje të pikëzimit dhe zbatimin e koeficientit 20%, duke u pikëzuar me 15 pikë.

Për sa i përket 2.B.a Numri mesatar i seancave, është 2.8 seanca numri dhe ndërmarrja e të gjitha veprimeve për shmangien e seancave joproductive.

Gjithashtu për sa i përket 2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, ka rezultuar që kryhen me efikasitet veprimet procedurale në të gjitha fazat, duke respektuar të drejtat e palëve dhe zhvillimin e gjykimit në kohë.

2.C.a Rregullshmëria dhe 2.C.b. saktësi e dokumentacionit të dosjes nuk ka të dhëna që mund të afektojnë negativisht pikëzimin dhe nivelin e vlerësimit.

Për sa i përket këtij kriteri të aftësive organizative, propozohet niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm” dhe pikët 100.

Për sa i përket “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, për të gjithë treguesit nuk ka pasur të dhëna të cilat mund të afektonin shkallën e aftësisë së gjyqtarës. Janë administruar të gjitha ankesat e paraqitura në ish-Inspektoratin e KLD-së dhe të administruara më pas nga ILD, ankesa të cilat i referohen kryesisht zgjedhjes në rrugë gjyqësore të pretendimeve të palëve. Të gjitha ankesat kanë përfunduar me vendim arkivimi dhe nuk janë evidentuar për efekt të vlerësimit etik dhe profesional.

Për sa i përket Integritetit, referuar raportit të ILDKPKI-së nuk është konstatuar

situata e konfliktit të interesit. Është konstatuar vetëm një kërkesë për përjashtimin e gjyqtarëve e cila është pranuar dhe 10 për heqje dorë të cilat janë pranuar gjithashtu.

Kështu që është vlerësuar numri i kërkesave të pranuar për përjashtim si i pakonsiderueshëm. Ka qenë vetëm një kërkesë dhe jo për konflikt interesi.

Për sa i përket “Aftësisë personale dhe angazhimi profesional”, është vlerësuar maksimalisht për të gjithë treguesit, me përjashtim të 4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve, që nuk ka pasur të dhëna; për 4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale, që nuk ka pasur të dhëna, dhe 4.C.ç Publikimet ligjore akademike, që nuk ka pasur të dhëna.

Përfundimisht pikëzimi 91 pikë për këtë tregues.

Në përfundim, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 391.

Kjo ishte pak a shumë në mënyrë të përmbledhur projektraporti i vlerësimit për 2017-2019 për gjyqtaren {...}, ndërkohë që raporti analitik përmban edhe përshkrimin më të detajuar të të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit..

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Ukperaj!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e projektraportit sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën 2017- 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
- Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 43 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.07.2023)

Pika 44 shtesë e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 12, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:27 dhe mbaroi në orën 12:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Illir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

10. Brikena Ukperaj (anëtare)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

7. Edmond Hoxhaj (BIRN).

RENDI I DITËS:

44 shtesë. Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 12, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i fundit të cilën e shtuam në rendin e ditës. Për më shumë detaje ia jap fjalën z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Pasi u konsultova me materialet po filloj relacionin përkatës që ka për objekt renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 12, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

(Lexohet relacioni)

Me disa vendime të datës 18.01.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi katërmbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 12, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 12 datë 18.01.2023 kandiduan gjithsej 8 (tetë) kandidatë, sipas tabelave që janë të inkorporuara në relacionin që unë po e prezantoj përpara mbledhjes.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për tre procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit nr.12/2023, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele.

Në vijim, me vendimin nr. 115, datë 13.03.2023, Këshilli ka vendosur: “I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Tiranë dhe Durrës, të shpallura me vendimet ku përfshihet edhe vendimi 12.

Sipas pikës 7, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”, në një procedurë lëvizje paralele për një pozicion të lirë, Këshilli i Lartë Gjyqësor bën renditjen e kandidatëve që përmbushin kriteret, renditje kjo që bëhet në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, i cili do të duhet të transferohet nëpërmjet mekanizmit të lëvizjes paralele.

Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit, të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, realizoi procedurat e verifikimit të plotësimit nga 5 (pesë) prej kandidatëve të kriterëve të mëposhtme (vlen të përmendet se z.{...} u tërhoq nga kandidimi i tij për pozicionet e shpallura me vendimet nr.11, nr. 12 dhe nr. 13 datë 18.01.2023).

U verifikuan kriteret e përvojës profesionale, mospasjes së masës disiplinore dhe mosqenies në papajtueshmërisë ambientale.

Kandidatët e kualifikuar sipas pozicioneve që kanë aplikuar janë: Matilda Llangozi, ku Këshilli verifikoi plotësimin nga ajo të kriterëve të kandidimit.

Me vendimin nr. 189, datë 25.04.2023 është vendosur “Përfundimi i procedurës së lëvizjes paralele, për pozicionet e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 11, nr. 12 dhe nr. 13 datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}.

Për kandidatin z. {...}, në përfundim të fazës së parë të lëvizjes paralele, me parashikimet e Kreut V të vendimit 320/2020 Këshilli verifikoi plotësimin nga ai të kriterëve të kandidimit dhe pas kualifikimit vijoi procedura e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.12, nr. 13 dhe nr. 15 datë 18.01.2023.

Për kandidatin z. {...}, është e realizuar e njëjta procedurë.

Edhe për kandidaten Nertila Kape është e njëjta procedurë verifikimi siç përmenda më lart për zotën {...}.

Siç u parashtua, krahas procedurave të verifikimit të kriterëve të kandidimit, paralelisht, për kandidatët vijuan edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional. Duke qenë se kandidatët përfshihen në listën e gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime për ta ishte e nevojshme përfundimi i vlerësimeve, konkretisht: 1) vlerësimi me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013–2016; 2) vlerësimi i 2-të, në mënyrë alternative si vlerësimi i përshpejtuar i detyruar për vitin kalendarik 2022 ose vlerësimi trevjeçar 2017–2019.

Me kualifikimin e kandidatëve në pozicionin respektiv nr. 12, bazuar në pikën 75 vendimit të Këshillit të përmendur më lart, Këshilli vendosi fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionet e shpallura me vendimin e tij nr. 12 dhe nr. 13 datë 18.01.2023.

Më datë 30.05.2023, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 75 e vijuese të vendimit të Këshillit “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, kandidatët e kualifikuar u njoftuan për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për pozicionet e lira, si dhe për caktimin e relatorit.

Në vijim të procedurës së përzgjedhjes në lëvizjen paralele për kandidatët në këto pozicione ka rezultuar se:

Znj. Matilda Llangozi është tërhequr nga kandidimi për pozicionin nr. 12.

Znj. Nertila Kape është tërhequr nga kandidimi për pozicionin nr. 12.

Lidhur me vlerësimet etike dhe profesionale për kandidatët e mbetur në garë u konstatua se:

Për kandidatin z. {...} a) Sipas Vendimit të KLD nr. {...} datë 30.04.2014, kandidati është vlerësuar për periudhën 2007–2009, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”. b) Me vendimin e Këshillit nr. 349, datë 06.07.2023, kandidati është vlerësuar për periudhën e vlerësimit 2017–2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 384 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim.

Për kandidatin z. {...} a) Sipas vendimit të KLD nr. {...} datë 13.11.2015, kandidati është vlerësuar për periudhën 2007–2009, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”. b) Sipas vendimit të Këshilli Pedagogjik si dhe Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. 20, datë 15.07.2021, i konfirmuar edhe nga vendimi i KPK, nr. {...}, datë 16.09.2021 konstatohet se subjekti i rivlerësimit {...} ka arritur rezultatin “Mirë”.

Vlerësimet etike dhe profesionale të kandidatëve janë konstatuar të jenë bërë përfundimtarë. Konkretisht për vlerësimet e z. {...}: i) Vendimi i KLD nr. {...} datë 30.04.2014 është i formës së prerë; vendimi i Këshillit nr. 349, datë 06.07.2023, për periudhën e vlerësimit 2017-2019 është i formës së prerë sipas deklaratës së kandidatit nëpërmjet postës elektronike më datë 12.07.2023. Për z. {...}: i) Vendimi i KLD nr. {...}, datë 13.11.2015 është i formës së prerë; ii) Ky gjyqtar, për shkak të vendimmarrjes së ndërmjetme të KPK ka ndjekur vitin akademik pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën 2020-2021, sipas kurikulave të miratuara për programin teorik e praktik, në përfundim të së cilit është vlerësuar në nivelin “Mirë” duke i kaluar mangësitë e parashtruara nga KPK. Vlerësimi përfundimtar në nivelin “Mirë” është miratuar nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. 20, datë 15.07.2021. Vendimi nr. 20, datë 15.7.2021, i Këshilli Pedagogjik si dhe Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës i konfirmuar edhe nga vendimi i KPK, nr. {...}, datë 16.09.2021. Ky vlerësim i është përcjellë Sekretarit të Përgjithshëm të Komisionit e

vëzhguesve ndërkombëtarë dhe është rimarrë në shqyrtim nga KPK, e cila me vendimin e saj datë 16.09.2021 ka konfirmuar në detyrë gjyqtarin, ku për kriterin e aftësisë profesionale ka pranuar vlerësimin e bërë nga Shkolla e Magjistraturës.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në përputhje me Kreun IV (Hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve), të vendimit 320/2020, relatori realizoi renditjen e kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur nga Këshilli për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë.

Lidhur me renditjen e kandidatëve u mbajtën në konsideratë pika 7, e nenit 43 të Ligjit për Statusin.

Për renditjen e kandidatëve u mbajtën në konsideratë hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve, sipas përcaktimeve të vendimit 320/2020.

Renditja e kandidatëve:

Në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 12, datë 18.01.2023, u përfshinë dy kandidatë, konkretisht: z. {...} dhe z. {...}. Për këta kandidatë u verifikua plotësimi i dy kërkesave të ligjit për të qenë pjesë e procedurës së përzgjedhjes për këtë pozicion të lirë, në kushtet kur ata ishin kualifikuar në procedurën e lëvizjes paralele ndërsa plotësonin kriteret e kandidimit, si dhe kishin dy vlerësime etike dhe profesionale, sikurse kërkohet për efekt renditje nga shkronja “a”, pika 7, e nenit 43, të Ligjit për Statusin.

Për renditjen e kandidatëve, fillimisht u ndoq hapi i parë i renditjes, ku për secilin kandidat u bë një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pika 7, shkronja “a”, e Ligjit për Statusin, si dhe i vendimit përkatës të përcaktuar më lart.

Sipas përcaktimeve të pikës 7, të nenit 43, të Ligjit për Statusin dhe vendimit 320/2020, rezulton se për kandidatin z. {...} kemi dy vlerësime: vlerësimi i parë është vlerësim i vitit 2007-2009, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”. Sipas Vendimit të Këshillit nr. 349, datë 06.07.2023, kandidati është vlerësuar për periudhën e vlerësimit 2017-2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 384 pikë.

Për zotin {...}, ekzistojnë dy vlerësime, vlerësimi i parë është “Shumë mirë”, për periudhën 2007–2009. Sipas Vendimit të Këshilli Pedagogjik si dhe Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, siç thamë, ai është vlerësuar “Mirë”.

Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, rezultoi që kandidati z. {...}, të ketë “Shkëlqyeshëm” dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kurse kandidati z. {...} dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale i ka “Shkëlqyeshëm” (nga KLD) dhe “Mirë”. Ky konstatim i referohet nenit 78, të Ligjit për Statusin.

Mbi këtë bazë arrihet të bëhet renditja e kandidatëve, për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 12, datë 18.01.2023, ku më lart renditet kandidati z. {...}, ndërsa kandidati tjetër z. {...} renditet pas tij. Meqenëse pas këtij hapi arrihet të përzgjidhet kandidati që renditet i pari referuar kriterëve të nivelit të vlerësimit, vijimi i hapave të tjerë të renditjes është i panevojshëm.

Për pasojë, renditja e kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 12, datë 18.01.2023, rezulton si më poshtë:

- 1) Z. {...};
- 2) Z. {...};

Bazuar në sa përcaktohet në pikat 18-21, të këtij vendimit, sikundër edhe në rezultatin e renditjes sipas pikës 23 të tij, relatori përgatiti projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 12, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Projektvendimi “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele, u shqyrtua nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në mbledhjen e datës 12.07.2023, sikurse përcaktohet në Kreun VI, të vendimit 320/2020, të Këshillit.

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Pika e parë e projektvendimit- Këshillit i propozohet të miratojë renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 12, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: 1) Z. {...}; 2) Z. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit, përcaktohet se një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve z. {...} dhe z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Së fundi, në projektvendimin përcaktohet se ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Këto ishin propozimet për pozicionin e shpallur me nr. 12 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kalojmë në votimin e projektraportit sipas propozimit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 12, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Z. {...};

2. Z. {...}.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve z. {...} dhe z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

4. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 44 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.07.2023)

Pika 45 shtesë e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 13, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:27 dhe mbaroi në orën 12:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Illir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

10. Brikena Ukperaj (anëtare)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

7. Edmond Hoxhaj (BIRN).

RENDI I DITËS:

45 shtesë. Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 13, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 13. Sërisht fjalën ia jap zotit Kurushi, i cili shkurtimisht do të prezantojë projekt-aktin.

Klodian Kurushi: Atëherë, shkurtimisht do prezantoj relacionin e radhës për pozicionin nr. 13 që kandidonin me dy vlerësime kandidatët z. {...} dhe znj. {...}. Ashtu sikundër e përmenda në relacionin që unë sapo parashtrova për pozicionin nr. 12, zoti {...} përzgjidhet si kandidat në renditje i pari për të vijuar më tej propozimin për lëvizjen paralele të tij, kështu që për pozicionin nr. 13, pasi zoti {...} ka hequr dorë dhe u

propozua për pozicionin nr. 12, si kandidate e vetme me dy vlerësime, në pozicionin nr. 13 mbetet kandidatja zonja {...}.

Ndodhur në këto kushte, duke qenë si kandidate e vetme, unë si relator i propozoj mbledhjes miratimin e renditjes në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 13, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim, pasi të votohet, të botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nëse s’kemi diskutime, kalojmë në votimin e projektraportit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 13, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me kaq po e mbyllim mbledhjen për sot.

Faleminderit!

* * *

(Pika 45 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor